



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 82, Datë 31.05.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIEZELA” SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“LJUSA” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 8, pika 8; nenit 10 pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW.

Konstatoi se:

- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 316 Prot, datë 26.04.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3; pika 4.1.4 gërmat “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar me nr. 2413/6, datë 15.12.2017 dhe në zbatim të VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*”, i ndryshuar, ka lidhur me MIE Kontratën me Nr. 15 Rep. dhe Nr. 8 Kol. datë 10.01.2018, “*Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e hidrocentralit “Ljusa” me kapacitet të instalaur 1980 kW, në Përroin e zallit të madh, degë e përroit të Lusës, kjo e fudnit degë fundore e krahut të djathtë të lumit Mat, Bahkia Mat, Qarku Dibër*”.
- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e qirasë nr. 1460 Prot., datë 05.06.2018, “*Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate konsiston në dhënien me qira të fondit pyjor – kullor për ndërtimin e HEC “Ljusa”. Nga kjo kontratë rezulton se mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral sipërfaqja e kërkuar është 2.507 ha dhe shtrihet në ngastrën : 178;173 të Ekonomisë Pyjore Derjan 1 dhe ngastrat 45 të ekonomisë pyjore Balgjaj si dhe do të merret në përdorim sipërfaqja prej 2.507 ha në pronësi të Bashkisë Mat. Kjo kontratë mban një afat një vjeçar që fillon nga e nesërmja e datës së nënshkrimit të saj. Referuar datës së nënshkrimit, afati i kësaj kontrate përfundon në datë 05.06.2019.*
- *Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10 pika 4 parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licensimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.*
- Në pikën 4 të nenit 8 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se : *Nese aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.*
- Afati i “Kontratës së qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k.”, përfundon në datën 05.06.2019. Si e tillë do

ti kërkohet shoqërisë të paraqesë në ERE brënda afatit të mbylljes së procedurave të licensimit, kontratën e rinovuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2 gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC do ti kërkohet shoqërisë të sjellë në ERE të plotësuar edhe të dhënat për tensionin e rrjetit të shpërndarjes; vitin e ndërtimit; datën e fillimit të operimit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit). Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, do ti kërkohet shoqërisë të paraqesë në ERE të plotësimet përkatëse për të dhënat që mungojnë që kanë të bëjnë me Prodhuesin e transformatorit dhe Skemën e lidhjes së përcjellësave). Neni 9, pika 4.1.4 gërma a (Dokumentacioni tekniko-ekonomik, Studimi i fizibilitetit, do të saktësohet me subjektin nëse ka të hartuar një studim fizibiliteti në një dokument të veçantë), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI